Migjeni

MIGJENI KËRKON LEXIME TË REJA

NGA **Nga Dr.Gazmend Krasniqi** Faqe 20-21

Migjeni nuk tregoi ndonjë shkollë të caktuar poetike, por megjithatë futi i pari shumë veçori që e përcaktojnë edhe sot zhvillimin letrar...

MOTIVET HOMERIKE NË VEPRËN E ANDON ZAKO ÇAJUPIT DHE KAVAFIT

85-vjet nga vdekja e autorit të madh shqiptar. Poezia "Kurbeti" dhe "Itaka" në nënshtratin ballkanik të poezisë botërore

NGA **Dorian Koçi**

Faqe 22-23



Andon Zako Çajupi

Konstantinos Petrou Kavafis

RILINDASI

Suplement i SHQIPTARJA.com

E diel
19 korik 2015
Viti **IV** - Nr:**80**
e-mail: rilindasi@gmail.com

Kryeredaktore;
Admirina Peçi

Dinastia e Sinajve/ Një profil për karrierën e pazakontë të bankierit të famshëm që tregtinë e kishte si oksigjen

BANKIERI GJERGJ SINA

Gjeniu nga Voskopoja, me një perandori finaciare në Austri

NGA **Pjeter Logoreci**

Në vazhdim të ciklit me shkrime për dinastinë Sina, mbi historinë e suksesëshme të kësaj familje nga Voskopoja, në Austri, po sjell disa informacione mbi jeten dhe aktivitetin shumë dimensional të një prej burrave më në zë në xhiron e bizneseve dhe të parasë, bankierit Gjergj Sina.

Po të kërkosh për Gjergj Sinen në arkivat e shtetit, por edhe ato private austriake, nga sasia e madhe e informacionit që gjindet, mund të krijosh një ide fillestare për xhiron gjigande të aktiviteteve tregtare, bankare, prodhuese, ndërtuese por edhe shoqërore të Bossit Gjergj Sina. Perandoria finaciare të cilën Gjergj Sina trashëgoj nga i ati Simon Sina dhe që e fuqizoi me tej, kalonte kufijtë e disa shteteve të fuqishme të kohës si perandoria osmane dhe ajo austrohungareze, duke u përhapur në të gjithë Europën e zhvilluar.

TË NJOHIM GJERGJ SIMON SINEN.

Gjergj Simon Sina lindi në Nish me 20 nandor 1782, nga martesa e Simon Sines (plakut) me vajzën nga Nish-i, Irene Czippe. Për të vërtetuar vendin e lindjes së tij nuk pat ndonji dokument, pasi në perandorinë osmane nuk lejohej....

VIJON NË FAQEN 18-19

SIMBOLET, ENVER HOXHA E STOLISI KAPELEN SI MBRETI ZOG

NGA **Dhurata Hamzai** Faqe 24

Të dyja kapelet kanë ornament degën e ullirit, simbolin e lavdisë. Studimi te libri i Valter Gjonit "Enciklopedia pa fund, qytetarët e nderit të Tiranës"

ARKIV | DOKUMENTET

Gjergj Simon Sina

Ndertesa ku gjindej Banka dhe Firma Simon Sina

NGA **PJETER LOGORECI**

vijon nga faqja 17

...një dokument pagëzimi. Vetë Gjergji e ka deklaruar më vonë, Nish-in si vendlindjen e tij, përsëri pa e pasur të dokumentuar, por të vërtetuar gojarisht nga pesë dëshmitare që ishin miq të familjes dhe "që e njihnin ate që fëmijë". Kur Gjergji ishte në moshën 10 vjecare, pas vdekjes së parakohëshme të nënës, babai vendosi që të largoheshin nga Nish-i për tu vendosur në Vjenë, kryeqendrën e fuqishme tregëtare e finaciare të perandorisë.

Sipas informacioneve të asaj kohe, (rreth viteve 1800) mendohej që numri i tregtarve "grek"(1) me shtetësi turke të cilët kishin firma të mirëfillta me aktivitet tregtar në Vjenë, ishte rreth 217-të.

Duke filluar nga viti 1803, Gjergj Sina ishte aktiv dhe drejtonte firmen bashkë me babain e tij, firmë që ishte pjesë e SHOQERISE së tregëtarëve "grekë" në Vjenë. Me 3 prill 1818, tre nga Sina-jt, babai i tij Simon, vëllai Johann dhe ai, morën titullin BARON. Thuhet që, si Gjergji ashtu edhe Simoni (i vjetri), që nga viti 1811 deri me 1818 përdorën në të mirë të tregtisë së tyre, shtetësinë e dyfishtë (turke dhe austriake). Në vitin 1822, për të nderuar figurën dhe veprën e babait (një vit pas vdekjes së tij), Gjergji, ja ndryshoj emrin e firmës që trashëgoi (që dikur quhej PAPA NAUM, SINA & CO) në SIMON GEORG SINA, duke marrë mbi vehte cdo detyrim si dhe kontaktet që babai kishte në zonat e perandorise osmane. Biografja austriake A.Lanier, e cila ka bërë historikun e bankës dhe bizneseve të familjes Sina, mendon që një gurë i fortë në themelin e kapitalit të FIRMES SINA ishin edhe disa situata që u krijuan në favor të Voskopojarëve. Ajo i referohet për këtë tregimeve që vetë Gjergj Sina ju ka shprehur bashkohësve e miqve të vet:..... ne familjarisht duhet ti falenderohemi,.... rritjes së kërkesës për lëndën e parë, pambukun (në fillimin e prodhimit të tij industrial), ...një lufte, ... disa vdekjeve që pasuan,.... si dhe rrotacionit të zyrtarve në disa organe shtetërore të perandorisë osmane....

Gjergj Sina hapi në Vjenë një firmë ku tregtonte mall me shumicë nga Ballkani, e cila "gëzonte mbrojtjen dhe privilegjet" e pashait vendas. Sipas historianëve, ishte koha kur akoma nuk kishte filluar eksporti i pambukut nga Amerika, ndërkohë që në zonat e Ballkanit, sidomos në Maqedoni, prodhimi i pambukut ishte në kulmin e lulëzimit. Pashai vendas, Ali Pasha, e ndaloj popullsinë që prodhimet ti tregtonte diku tjetër dhe mori për vehte monopolin mbi pambukun, duke e mbledhur për të ja shitur më pas bashkëatdhetarit Sina, i cili kishte nënshkruar në Manastir një kontratë të rregullt me pashain. Tregtia në mes tyre do të funksionontе si një Shoqëri e mirëfilltë. Pashai duhej ti dërgonte pambukun Sines me një cmim për të cilin ishin kuptuar bashkë, ndërsa Sina duhej ta shiste. Nga fitimi i përbashkët, sipas marrveshjes dy palëshe, Sina ishte i detyruar të administronte edhe pjesën e fitimit të ortakut. Ali Pashai trembej që Sulltani një ditë do të hakmerrej dhe për cdo gjë që mund të ndodhte, bankieri Sina ishte i detyruar që, sipas kontratës, ti jepte familjes së pashait pjesën e fituar. Për vite me radhë, kjo tregëti solli fitime të mëdha. Edhe luftrat që po bënin francezët, sollën një ndikim pozitiv në shitjen e lëndës së parë, pambukut që i duhej ushtrisë për veshmbathje. Por erdhi një ditë, që Sulltani arriti të ndëshkojë Ali Pashain, duke e vrarë atë vetë, si dhe djemtë e tij. Ai arriti të fshijë nga faqja e dheut të gjithë familjen e pashait rebel. Kështu që Gjergj Sina u bë trashigimtari i vetëm ligjor i shumës stërmadhe të fitimit që i përkiste Ali Pashait. Kjo gjë është konfirmuar edhe në gazetën e mbrëmjes Pester Lloyd, e cila me rastin e vdekjes së Gjergj Sines, në numrin e saj të 20 maj 1856-es, në një kronologji që botoj mbi jetën dhe karrieren e Gjergj Sines shkruante: ...Ai (Gjergj Sina) duhet ti falenderohet .....të famshmit e të plotfuqishmit Ali Pasha nga Janina, me të cilin në atë kohë zhvilloj një tregti të përmasave të mëdha, nga ku i vjen një pjesë e madhe e kapitalit bazë të firmës.... Thuhet që për këtë arsye, rreth vitit 1847, qeveria turke i kërkoj Vjenës që ta ekstradojë Gjergj Sinen, një kërkesë që nuk u realizua kurrë.

Gjenialiteti i Gjergj Sines si afarist dhe financier bëri që pjestarët e tjerë të familjes Sina të mbesin "në hije" edhe pse patën një aktivitet të mirëfilltë tregëtar dhe social. Në mbretërinë e financave të perandorisë, ai filloj të thirrej "Gjergji i madh" ose "para-lija Sina". Talentin për të bërë tregëti që trashëgoi nga babai e zgjeroj dhe me tej duke vendosur kontakte pune në tërë Europën. Me fillimin e eksportimit të pambukut si lëndë e parë për industrinë europiane nga Amerika, Sina


Seiner Hoch- und Wohlgeboren
dem
Hochverehrten Herrn Herrn
GEORG FREYH. v. SINA
DE
HODOS & KIZDIA,
General-Consul Sr. Majestät des Königs Otto von Griechenland am k. k. Wiener Hofe; Commandeur des königl. griechischen Ordens vom heil. Erlöser, und des kaiserl. türkischen Nischan-Iftihar-Ordens; Magnat des Königreichs Ungarn, Ehrenbürger mehrerer königl. ung. Freistädte, Landstand in Oesterreich, Böhmen, Mähren und Schlesien; Director der priv. k. k. österreichischen Nationalbank, der Wien-Raaber Eisenbahn und mehrerer anderer industrieller Unternehmungen; Deputirter des k. k. priv. Grosshandlungs-Greminms; k. k. priv. Grosshändler etc. etc.

Dokumenti i marrjes se titujve te nderit nga Gjergj Sina

Harte e Voskopojes 1742



Voskopoja dhe rrethinat

Dinastia e Sinajve

Gjeniu Gjergj Sina nga Voskopoja dhe perandoria e tij finaciare në Austri

Me një inteligjencë të pashoqe drejtonte bizneset dhe rriste zotërimet e tija. Puna ishte për të si oksigjeni. Edhe pse në moshën 70 vjecare, punonte nga mëngjesi deri vonë në darkë. Qëllonte që kalonte netë të tëra në zyrë…

humbi monopolin dhe tregëtia me këtë mall u dobësua shumë. I prirë nga nuhatjen e tregëtarit të lindur, ai filloj të kërkojë mëndyra të tjera biznesi. Gjergji nuk vonoj të futej me sukses në tregtinë e duhanit, ku në vitin 1851 pat monopolin e tij në Hungari, por pa lënë pas dore edhe tregtinë me mallrat e tjerë si; druri, qymyrigurit dhe krypa, që i sillnin fitime të mëdha. Gjergj Sina nuk ishte vetëm burri më i pasur i perandorisë, por krahas bankës Rothschild, ai ishte zotëruesi dhe drejtuesi i bankës më të suksesshme të Austrisë, e cila pat kulmin fitimeve në vitin 1848 nga obligacionet e shtetit dhe nga dhënia e kredive për ndërtimin e ujësjellësit, bashkisë së Vjenës. Duke praktikuar letrat me vlerë, kambialet (urdhër xhirimi), dëftesa borxhi, banka Sina arriti të fitojë shuma marramendëse. Nga aftësitë e tija të vecanta si burrë i financave, në vitet 1825 deri 1849 ai u zgjodh si drejtor i bankës kombëtare të perandorisë dhe nga 1849 deri 1856 (deri sa vdiq) zëvendës guvernator i po kësaj banke.

Gjergj Sina me një inteligjencë të pashoqe drejtonte bizneset dhe rriste zotërimet e tija. Puna ishte për të si oksigjeni. Edhe pse në moshën 70 vjecare, punonte nga mëngjesi deri vonë në darkë. Qëllonte që kalonte netë të tëra në zyrë.

Tregojnë që një herë në një mëngjes të bukur me diell, teksa zbriste shkallët e ndërtesës së bankës, një i njohur që banonte në pallatin pranë tij i habitur e pyeti:... si zotni Baron, nuk keni shkuar mbramë në fshat (ku ishte vila e tij familjare)? Baroni i milionave u pergjigj i shkujdesur: ....Nuk kam kohë...

Gjergj Sina edhe pse drejtor dhe pronar i bankës, priste me përulësi këdo: ...si bankierin superpasanik që i propozonte lëvizje të mëdha parash apo fitime të mëdha, ashtu dhe tregtarin e thjeshtë që i ofronte veprime të vogla biznesi. Me secilin bisedonte dhe negocionte vetë. Ishte pasioni i tij të bënte "tregtarin". As përfitimet finaciare dhe as mënyra e fitimit nuk ishin qëllimi i jetës së tij, por kushtet e jetesës, realizimi i dëshirave dhe elementeve të jetës aktive. Ishte i saktë dhe i vëmendshëm deri në detajet me të vogla në jetën e tij private dhe profesionale.....

Tregojnë që,... shërbëtori i kërkoj leje të blejë një dry që i nevojitej ....

- "Shiko në katin e sipërm, atje gjinden disa, të vjetër por funksional – ju pergjigj baroni Sina". Por, shërbëtori nuk arriti ti gjejë dhe u kthye nga lart duar bosh. Atëherë multimilioneri Gjergj Sina, i dyti burrë i pasur i perandorisë, u ngjit vetë në papafingo dhe u kthye duke sjellë me vehte një dry të përdorur, por në gjendje pune.

Vemendja, ishte një nder dhuntitë e rëndësishme në aftësitë dhe karakterin e gjeniut GJERGJ SINA....

Ky serial shkrimesh per dinastine Sina vijon në numrat e ardhshëm....

Shenime:

(1)Voskopojarët të cilët ishin me besim kristian ortodoks shiheshin nga popullsia e Vjenës si GREKE...

Vjenë, me 10 korrik 2015

RILEXIMI | VEPRAT

Migjeni kërkon lexime të reja

Migjeni nuk tregoi ndonjë shkollë të caktuar poetike, por megjithatë futi i pari shumë veçori që e përcaktojnë edhe sot zhvillimin letrar – vetëm një vështrim i vëmendshëm mund të përcaktojë se ato veçori janë kryesisht migjeniane...

NGA **NGA DR.GAZMEND KRASNIQI**

Migjeni në 1935

RI)LEXIMI SI PËRBALLJE ME LEXIMET KONVENCIONALE

Duket sikur ka bërë vend shqetësimi se sot flitet pak për Migjenin, se ai është mënjanuar nga studimet letrare. Ndoshta theksohet kjo "pak", si për të thënë se për këtë poet dikur është folur shumë, duke u popullarizuar, gati duke u bërë një simbol i shkrimit të poezisë, saqë për dikë tjetër mund të ngrihet pyetja se mos ndoshta janë thënë aq shumë gjëra, pra nuk ka mbetur gjë për të thënë, apo se mos ndoshta kemi zgjimin e një qëndrimi të caktuar politik, sipas disa pretendimeve nga rrethe të tjera të caktuara.

Mendojmë se ky shqetësim përligjet nga shkrimet e shumta të bëra dikur për të e poezinë e tij, nga futja e vazhdueshme dikur e poezive të tij në tekstet shkollore dhe mënyra e komentimit të tyre - përgjithësisht sociologjik. Kjo është fizionomia më e popullarizuar e këtij poeti. Një anë tjetër e kësaj fizionomie është përdorimi politik dhe ideologjik i kësaj poezie si kundërvënie ndaj një letërsie të etiketuar për disa dekada si reaksionare, kryesisht ndaj emrave si Fishta e Koliqi.

Teksti Historia e letërsisë shqiptare (1983) ndoshta e përcakton këtë që thamë, kur shkruan: Migjeni dhe vepra e tij u bënë objekt i vazhdueshëm studimi. Kritika dhe historiografia letrare borgjeze e vendit, para Çlirimit, dhe e jashtme, në ditët tona u orvatën ta paraqitin shkrimtarin si një "yll krepuskolar", apo si një ithtar të rrymës borgjeze të "të zhgënjyerve" në prag të Luftës së Dytë Botërore; bile edhe ta nënvlefësonin vlerën e artit të tij. Kritika dhe historiografia jonë letrare, të mbështetura në metodologjinë dhe estetikën marksiste-leniniste, i kanë bërë veprës së Migjenit një vlerësim dialektik dhe i kanë dhënë poetit vendin që i takon në letërsinë shqiptare. Meritat e veprës së tij, tanimë janë çmuar në shkallë botërore.

Ky është një përfundim, por vetë trajtimi te zëri Arti i Migjenit, gjuha, ka nga këto shprehje kyçe:krahas paraqitjes së mjerimit të popullit, urrejtjes së grumbulluar te masat, protestës e revoltës së tyre, shkrimtari, në emër të forcave të reja shoqërore, bëri thirrje për përmbysjen e rendit të padrejtë politik, ekonomik e shoqëror.

Duket qartë se, nën shtysat e pozitivizmit apo të realizmit socialist, asaj krijimtarie i kërkoheshin detyra shumë më të mëdha sesa mund të kërkohen nga një vepër arti. Kështu figura e tij të bëhej e përdorshme për qëllime jashtëletrare, siç kishte ndodhur edhe në esenë e një shkrimtari me shumë ndikim si Kadareja: Migjeni – një uragan i ndërprerë. E përmendim këtë, sepse eseja nuk ishte botim i rastit, por parathënie e botimit të plotë të veprës së Migjenit.

Shqetësimi i mësipërm na tregon që edhe pas kaq dekadash shohim se nuk është konsoliduar, sado përafërsisht, figura e një poeti si ai. Me një vështrim, sado sipërfaqësor, do të shohim se peshorja e studimeve rëndon nga studimi i jashtëm i kësaj poezie, gjë që e ka bërë të luhatshme figurën e këtij poeti dhe na nxit për vështrimin tjetër – atë të brendshëm.

Ka pasur një kohë përpara këtij studimi të jashtëm, kur Migjeni i nënshtrohej një studimi të brendshëm. Atë vit që vdiq Migjeni, kemi punimin që thotë se ai iu largua metrikës tradicionale, ritmeve dhe rimave të saj, pasi u bë dominante asonanca, e cila nuk qe pranuar më parë. Sipas këtij punimi, Migjeni ia dha asaj vendin e nderit në poezinë e vet sepse ajo asht ma delikate në tingull, se nuk ta vret as syrin as veshin, ngaqi asht ma e shpeshtë e ma e larme se rima. Po si mund të ketë poezi pa ritëm e rimë, ngrihet pyetja. Autori i punimit e ngre pyetjen për t'iu përgjigjur po vetë. Nji kësij pyetje e bajnë ata qi s'e dallojnë vargun metrik nga poezia. Tue përziem vargonim e poezi, ata harrojnë se ka vargje të përpikët pa farë poezie brenda, e prozë qi asht poezia vetë. Me fjalë të tjera, për Migjenin – si edhe për ne – poezia nuk asht as vargu, as proza, por diçka që shfaqet në to, tue u dalluem prej tyne. Prandaj nuk mund të themi se Migjeni s'asht poet, vetëm se të shprehunit e tij vesh nji rrobe që i përngjan hem vargut, hem prozës, qëndron në mes të të dyjave.

Në vazhdën e këtij trajtimi është edhe Qemal Draçini, kur thotë për Migjenin, ka të simbolizmit paraqitjet e gjendjeve të brendshme shpirtnore me simbole të jashtme, pasqyrimin e shpirtit n'objekte të natyrës, ka vetë "vargun e lirë" e krijimin e asonancës, tonin fonologjik të vjershës – por mungon në përgjithësi muzikaliteti i përkryem i vargut, stolisja metaforike, paraqitja trashendentale e fytyrimit.

Këto teza nuk patën zhvillim të mëtejshëm, sepse u përcaktuan edhe nga e ardhmja e atyre që i hodhën.

E para i takon një studiuesi (Dhimitër Shuteriqi) që, i prirur për drejtime të reja letrare (kupto: përmbajtësore) kaloi në drejtim tjetër, duke u bërë kodifikuesi i realizmit socialist.

E dyta nuk mund të gjente vend te studimet që kërkonin t'i paraqisnin shqetësimet e tij individuale vetëm si sociale. (Përveç të tjerash - një tjetër faktor jashtartistik - autori i kësaj teze vdiq si armik i regjimit.)

I brendshëm është edhe gjykimi i Koliqit – edhe pse ka vend për të diskutuar gjatë prej njohësve për raportin migjenian me poetët "e zhgënjyer" serbë - kur shkruan për të: Lidhet me grupimin e poetëve serbë të quejtun razo-carani (të zhgënjyemit). I stolisi poezitë e veta me reminishenca që vijnë nga kjo rrymë. Veç të tjerash, poezia e tij tash asht shprehë me nji shqipe të pasigurtë e jo të njitrajtshme, qi nxjerr në pah mungesën intime të çdo zàmi idiomatik. Ai, i vlersuem nëpërmjet nji kriteri të pastër estetik, mundet me e ruejtë nji vend në letërsinë mikpritëse shqiptare, por jo aq falë poezisë së tij të vrudhshme me sfond social, sa falë do modulacioneve të thjeshta qi t'kujtojnë Corazzini-n...

Është fjala për këto vargje të Corazzini-t, i cili së bashku me disa shokë të tij, ashtu si dhe Migjeni, qenë goditur nga sëmundja e pashërueshme e kohës - tuberkulozi:

Oh, po unë jam, unë jam vërtet i sëmurë!
E vdes pak nga pak, çdo ditë.

Është e qartë se krahasimi duhet bërë me këto vargje të Migjenit:

Dalngadalë po shof
Si jeta një nga një
Secilën ndjesi
Me tradhti
Po ma vulos

Migjenin në poezinë shqipe ka vend të qëndrueshëm vargëzimi i mbështetur në ritmin e të folurit emocional sipas stilit të gjuhës bisedore, me elemente të rrëfimit lirik



▶ **Një variant i vjershës "Malli rinuer"**

Me sa duket, ky mendim i Koliqit plotësohet nga Qemal Draçini, megjithëse ky e ka shprehur këtë ide shumë më herët. Draçini thotë se te vargu i Migjenit shpesh mbresët, ngashërimet, ndjesit, me një fjalë bota e brendshme shpirtnore shpërthen jashtë me ashpërsin e një shprehjeje së mbledhtë me gjasë të një formyle logjike. Apo idetë përmblidhen në një frazë si aforizma.

Një ilustrim i mendimit të Draçinit do të ishte ky:

Na, të birt' e shekullit të ri,
me hovin tonë e të ndezun peshë,
ndër lufta të reja kemi m'u ndeshë
dhe për fitore kem' me ra fli.

Në fakt, pas kësaj shprehjeje së mbledhtë me gjasë të një formyle logjike, përgjithësisht në segmente të shkëputura të tekstit, kapeshin interpretimet themelore që i bëheshin leximit të Migjenit, duke u realizuar pikërisht ajo që i druhej ky poet: propagandimi para artit. Ilustrime të tilla mund të gjejmë disa - deri të më të pakapshmet apo banalet - por ky interpretim, sigurisht, binte ndesh me mendimet e shprehura nga autori për këtë problem, kur te letra që i dërgonte redaksisë së revistës "Bota e re", thoshte: Mendoj se kryesorja në gjitha artet është artistikja. Sepse, pyet ai: A thua poezia qytetare sociale nuk ka të drejtë në përkryerjen artistike; apo detyra e saj është – të jetë vetëm pllakat?

Studimi i brendshëm do të na e bënte më të qëndrueshme figurën e Migjenit: një nga "thyerësit" dhe, rrjedhimisht, një nga pohuesit e mëdhenj të traditës poetike shqipe.

Koliqi kishte shqetësime konkrete të historiografisë shqipe kur sillte në vëmendje se: Në përshtypje të parë Majakovskij, Esenin, Pasternak e tjerë shkrimtarë të Kryengritjes së Tetorit duken kryekëput të shkëputun nga vija historike e zhvillimit letrar rus. Por, po të vrehet me vëmendje nënshtresa e veprave të tyne, shihet se ndjekin me trajta e frymë të re (ndoshta jo me art më të lartë) gjurmat e Pushkinit, të Tolstojit e të Dostojevskit. Kjo bëhet më e qartë kur shikon se, herë drejtpërdrejtë, herë jo, ai kërkon të shpjegojë raportet e tij me Migjenin, për të cilat gjykon se në Tiranën zyrtare po spekulohet, duke ia kundërvënë atij vetë. Sipas tij, Migjeni u imitue nga nji varg i dendun shkrimtarësh të rinj, por nuk arriti me krijue nji shkollë pikërisht sepse u shkëput nga tradita letrare vendase.

Draçini e çon më tej këtë ide kur shprehet: Me Migjenin çelet e mbyllet njiheri nji anë e veçantë e poezis së mendimit shqiptar. E njimend: Migjeni u imitue në trajtë e në formë të vargut, ndoshta edhe n'atë t'ekspresionit, por nuk u ndoq edhe në mendim rryma e tij.

Kjo mënyrë diskutimi për Migjenin merr vlerë të veçantë po të kujtojmë se, për gati pesëdhjetë vjet, duket sikur ndër poetët shqiptarë është parë si shenjë e bashkëkohësisë vargu i lirë, por po ta shohësh me vëmendje, kupton se shpesh kemi të bëjmë me një keqkuptim që lidhet me titullin e librit poetik të Migjenit, i cili, në të vërtetë, nuk ka aluduar për poetikë por për etikë, sepse në vargjet e tij të çlira kemi vetëm gjurmë të atij që duhet ta quanim varg të lirë. Pipa pohon se titulli "Vargjet e lira" lidhet më pak me metrikën, sesa me karakterin e protestës. Për fat, në studimet më serioze kjo është vënë në dukje: "I revoltuar në jetë dhe në art" – në këtë kuptim të dyfishtë duhet marrë titulli i përmbledhjes "Vargjet e lira".

Pipa është i mendimit se në një vend ku poezia shoqërore nuk është gjë e re, poeti i "Vargje të lira" nuk do të dallohej shumë prej grupit të shkrimtarëve të tjerë shoqërorë. Por në Shqipëri është një i vetëm, është një pionier; Puna e pionierit mund të ketë qenë edhe vetëm një kushtrim, edhe vetëm një gjest. Por ky gjest asht fatidik, ky kushtrim ka randsi. Arshi Pipa pajtohet me idenë se: Hymja e Migjenit në letërsin shqipe shënon një datë.

Kjo hymje asht e vrullshme dhe e then traditën. Sipas argumentit të tij, në atë çast historik të poezisë shqipe qe gjë e rrallë për një poet që të mos shfaqej me tetërrokëshin shqiptar, çka do të jetë karakteristikë e shumë poetëve shqiptarë pas tij, prandaj sot e dallojmë me zor këtë cilësi migjeniane. Këtë ia shikon si heterogjenitet kulturor, sepse një poezi që kërkon të jetë antitradicionale, kërkon të lëvizë lirisht. Si jo shqiptare, Pipa ia shikon edhe sensin e fortë të metaforës. Kalimet e dhunshme apo kontrastet e thella janë një gjë e re në poezinë shqipe.

Sipas tij, që të shihet në brendësi përplasja me tradicionalen, vlen të krahasohet me kujdes poetika migjeniane me atë që gjallonte më përpara: kështu do të dallojmë regjistrin e veçantë stilistik të këtij poeti. Vlen të përmendim analizat që i janë bërë figurave gramatikore (inversionit dhe elipsës), figurave të diksionit (sinekdokës dhe krahasimit), apo figurave të tjera (thirrjes retorike dhe hiperbolës), aliteracionit dhe ritmeve origjinale.

Vlen të përmendet pohimi se që me Migjenin në poezinë shqipe ka vend të qëndrueshëm vargëzimi i mbështetur në ritmin e të folurit emocional sipas stilit të gjuhës bisedore, me elemente të rrëfimit lirik dhe nëpërmjet pyetjeve ose dialogut, me shumë krahasime po ashtu të bisedës së gjallë, me përpjesëtimin më të madh të foljeve kundrejt epiteteve poetike etj; se në këtë mënyrë vargu: Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi, do të shihet ashtu siç do të niste çdo bisedë, pra me tiparet e ligjërimit bisedor. Por në këtë ligjërim, në fakt, fshihet edhe një metaforë e fortë, e cila flet për një ligjërim bisedor shumë të ngritur, duke bërë të qartë talentin e mirëfilltë të poetit.

Studiuesit vërejnë se Migjeni arrin të krijojë ritme të ndryshme ndër poezi të ndryshme. Ai arrin edhe të ndryshojë ritmin brenda një poezie, si tek "Baladë qytetse". E përshkruan gruan:

...një hije gruaje,
një kens këso bote,
një fantom uje...

Por kur vjen puna për të folur për vallen e gruas së mjerë nëpër rrugët e qytetit, në mënyrë që sarkazma të dalë më e dukshme dhe therrëse, menjëherë e ndryshon ritmin, ndërton vargje me aliteracione, me rima të pasura etj.

...vallzonte valle në rrugë të madhe.
Dy hapa para, dy hapa prapa
me këmbë të zbathun,
me zemër të plasun...

Migjeni është i pari në poezinë shqipe që përdori rimën apofonike (konsonancën):

...therin qiellin kryeqat dhe minaret e ngurta,
profetent dhe shejtent në fushqeta të shumëngjyrta...

Është i pari, pas Poradecit, që përdori pauzën.

Përsëritja është një element artistik i përdorur me shumë efekt prej këtij poeti.

Na bëhet se nuk gabojmë, shkruan studiuesi Zheji, kur themi se zbulohet diçka e sensibilitetit muzikor të Migjenit dhe, në të njëjtën kohë, diçka që e lidh atë me vargëzimin dhe intrumentalizmin popullor... Ky studiues përmend raste të shumta të përsëritjeve migjeniane, por le të marrim vetëm njërën prej tyre:

Kangë Perndimi, kangë njeri të dehun nga besimi në vete...
Kangë e tij nji fe tjetër...

Një mjet artistik i përdorur me mjeshtëri prej tij që, padyshim, dëshmon edhe shkollën e Mjedës, është bartja. Ja një epitet që përcillet me bartje:

...me fytyrë të zbehtë dhe me syt
të zez si jeta e saj..

Nga pikëpamja e poetikës është pranuar se ai ka pasur edhe afërsi me ekspresionizmin dhe ekspresionistët. Kanë tipare të shumta ekspresioniste:

-temat (mjerimi, papunësia, prostitucioni, fatalizmi);

-personazhet (fëmijët, gratë, murgeshat, mantenutat, studentët, intelektualët kundërshtarë të moralit patriarkal etj.);

-idetë (kritika e sistemit shoqëror dhe fryma antifetare);

-vizionet (vizioni i mbinjeriut dhe i botës së re, në njërën anë, por edhe i fundit të botës nën anën tjetër);

-mjetet shprehëse që përdor ky poet e prozator dhe format letrare që kultivon ai (poezia lirike dhe proza e shkurtër).

Këto që përmendëm, e të tjera si këto, na tregojnë se vërtet Migjeni nuk tregoi ndonjë shkollë të caktuar poetike, por megjithatë futi i pari shumë veçori që e përcaktojnë edhe sot zhvillimin letrar – vetëm një vështrim i vëmendshëm mund të përcaktojë se ato veçori janë kryesisht migjeniane, duke u përvetësuar e tretur me kohë në ligjërimin e poetëve të tjerë, që nga Kadareja apo poetë të tjerë, të rëndësishëm apo të parëndësishëm. Nëse në periudhën e realizmit socialist, apo edhe përtej saj, Migjeni ka ndikuar shumë me atë që Qemal Draçini ia shikon si vërejtje, pra me vargun që vuan nga "formyla logjike", ky nuk është faji i tij.

Me këtë mënyrë qasjeje mendojmë se arrijmë në përfundimin që studimi i brendshëm do të na e bënte më të qëndrueshme figurën e Migjenit: një nga "thyerësit" dhe, rrjedhimisht, një nga pohuesit e mëdhenj të traditës poetike shqipe. Megjithëse një nga autorët më të studiuar të letërsisë shqipe, Migjeni kërkon lexime të reja.

Theksojmë se në këtë kuadër të tekstit dhe kontekstit, përveçse ndaj imponimeve politiko – ideologjike, historiani i letërsisë duhet të jetë i vëmendshëm edhe ndaj problemeve të brendshme letrare, si për shembull ngatërresat e tipologjive.

Duke vlerësuar vërejtjet e evidentuara gjatë këtij shtjellimi, do të dilnim në përfundimin se (ri) leximi mbetet themelor, hap i parë, në objektivat dhe strategjinë e paradigmës së Historisë letrare.